



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**ADGJA.nr.09/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkritazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga V.Gj, nga ....., komuna e Gjakovës, ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, M.K, N.B.D dhe H.R, lidhur me vendosjen në lëndën Ac.nr.7716/22, të Gjykatës së Apelit në Kosovë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 16.11.2023, mori këtë:

## **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga V.Gj, nga ....., komuna e Gjakovës, ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, M.K, N.B.D dhe H.R, lidhur me vendosjen në lëndën Ac.nr.7716/22, të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

### **A r s y e t i m**

Me datën 27.10.2023, përmes emailit zyrtar nga Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Gjykata e Apelit e Kosovës, e ka pranuar ankesën të parashtruar nga V.Gj, nga ....., Në ankesë i njëjti ka pretenduar se gjyqtari i çështjes më se një vit radhazi nuk e ka shqyrtuar lëndën Ac.nr.7716/22 edhe pse lënda është për herë të dytë në Gjykatën e Apelit, duke theksuar se gjykata e ka për obligim që rastet e tilla të cilat janë në rigjykim t'i vendos brenda afatit për 15 ditë, ndërsa në rastin konkret lënda nuk është vendosur që një vit, andaj ka kërkuar nga kryetari i Gjykatës së Apelit, që ndaj gjyqtarit i cili e ka zvarritur lëndën t'i shqiptohet masa disiplinore ndaj tij, ngase lënda me ankesë është për herë të dytë, më gjerësisht sikurse në ankesë.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës, me datën 02.11.2023, nga kolegji gjykues i Gjykatës së Apelit në lëndën Ac.nr.7716/22, në përbërje prej gjyqtarit M.K - kryetar kolegji dhe gjyqtareve N.B.D dhe H.R, anëtare të kolegjit, ka kërkuar deklaram lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi V.Gj.

Gjyqtari M.K, ka dhënë deklaratë me datën 10.11.2023, ku ka theksuar se lëndën në fjalë e ka pranuar me datën 31.12.2022, mirëpo ende nuk është vendosur për arsye se ka një numër të madh të lëndëve, respektivisht 620 lëndë në punë dhe prej tyre ka një numër të madh të lëndëve me prioritet ligjor dhe lënda në fjalë nuk është kryer jo pse nuk ka dashur ose e ka neglizhuar punën por për shkak të pamundësisë që të gjitha lëndët të trajtohen në kohën e duhur. Tutje ka theksuar se i njëjti ka në punë edhe lëndë të vitit 2019, 2020 dhe pastaj edhe ato të vitit 2021 dhe 2022, e që kanë prioritet ligjor. Gjithashtu ka theksuar se si kryetar i kolegjit, për çështjen në fjalë është i hapur dhe në dispozicion për çfarëdo informate apo plotësimi të nevojshëm që mund t'i shërbejë shqyrtimit dhe vendosjes së ankesës, më detalisht sikurse në deklaratën e tij.

Gjyqtarja N.B.D, ka dhënë deklaratë me datën 07.11.2023, ku ka theksuar se me verifikim në regjistrin e lëndëve SMIL, me këtë lëndë është ngarkuar gjyqtari M.K, kryetari i kolegjit, ndërsa ajo është vetëm anëtare e kolegjit dhe nuk është e ngarkuar me lëndën në fjalë, respektivisht lënda nuk gjendet në zyrën e saj dhe rrjedhimisht mbledhja e kolegjit për lëndën me të cilat është i ngarkuar kryetari i kolegjit, caktohet nga kryetari i kolegjit duke respektuar radhën e arritjes së lëndëve në gjykatë. Tutje ka theksuar se si gjyqtare-anëtare e kolegjit, për çështjen në fjalë është e hapur dhe në dispozicion për çfarëdo informate apo plotësimi të nevojshëm që mund t'i shërbejë shqyrtimit dhe vendosjes së ankesës, më detalisht sikurse në deklaratën e saj.

Gjyqtarja H.R, përmes emalit zyrtar ka dhënë deklaratë me datën 04.11.2023, ku ka theksuar se nga regjistri i lëndëve me të cilat është e ngarkuar e po ashtu edhe sipas fletores së ngarkimit me lëndë nga shkrimorja e gjykatës, rezulton se në lëndën me numër Ac.nr.7716/22, e njëjta nuk është e ngarkuar si gjyqtare e çështjes dhe të njëjtën e ka verifikuar edhe në Sistemin e Menaxhimit të Lëndëve-SMIL, nga ku edhe ka rezultuar se lënda në fjalë është e regjistruar në emër të gjyqtarit M.K, më detalisht sikurse në deklaratën e saj.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarëve M.K, N.B.D dhe H.R, ka gjetur se:

- ankesa e ankuesit V.Gj, është **e pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi si dhe deklaratave të gjyqtarëve, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket zvarritjes së procedurës në mos zgjidhjen e lëndës Ac.nr.7716/22 nga gjyqtari i çështjes, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se gjyqtarët janë të pavarur në vendimmarrje, pavarësi kjo e cila i'u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu gjyqtarët janë të pavarur në punë e tyre, vendosin sipas ligjit dhe vendimet merren në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim kryesor. Sipas vlerësimit të kryetarit, pavarësia individuale, është pavarësia e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor, që nënkupton se gjyqtarët duhet

të jenë meritore, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor.

Në Gjykatën e Apelit të Kosovës lëndët zgjidhen sipas radhës së arritjes së tyre, si dhe llojit dhe natyrës së tyre, për faktin se varësisht prej natyrës së kontestit një lëndë mund të jetë më me prioritet se lënda tjetër, pavarësisht faktit se të dy lëndë mund të kenë ardhur në të njëjtën kohë. Nga shkresat e lëndës rezultoi se lënda në fjalë sipas Sistemit të Menaxhimit të Lëndëve-SMIL, në mënyrë automatike i është ndarë gjyqtarit M.K, si kryetar kolegji ndërsa anëtar të kolegjit gjyqtarja N.B.D dhe gjyqtarja H.R. Kryetari i Gjykatës së Apelit, vlerëson se lëndën në fjalë, kryetari i kolegjit, gjyqtari M.K, e ka pranuar me datën 31.12.2022, ndërsa i njëjti në punë ka edhe lëndë të viteve 2019, 2020 dhe 2021, e të cilat presin në radhë për t'u zgjidhur, andaj sipas radhës së arritjes gjyqtari i çështjes do t'i trajtoj edhe lëndët të cilat i ka në punë.

Gjithashtu Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), me datën 08.06.2022, ka miratuar Planin Strategjik për Përmasimin e Qasjes në Drejtësi për vitin 2022-2025, konkretisht për efikasitetin dhe prioritetin e lëndëve brenda sistemit gjyqësor, si dhe Planin Strategjik për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për periudhën 2022-2024. Qëllim i planeve të lartcekura është trajtimi i lëndëve brenda afatit të arsyeshëm kohor i përcaktuar me legjislacionin në fuqi dhe me instrumentet ndërkombëtare të zbatuara, si dhe zvogëlimi i lëndëve. Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar sipas legjislacionit në fuqi si dhe udhëzimeve të KGJK, në muajin maj të vitit 2023, ka miratuar Planin e Veprimit për zgjidhje efikase të lëndëve të vjetra dhe lëndëve në fokus të Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi në Gjykatën e Apelit të Kosovës, që qëllim ka rritjen e efikasitetit në trajtimin dhe zgjidhjen e lëndëve që kanë një afat më të gjatë të pritjes si dhe të atyre që përcaktohen për nga natyra si lëndë me prioritet. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, kryetari i Gjykatës së Apelit vlerësoi se gjyqtari M.K lëndët të cilat i ka në punë është duke i trajtuar konform legjislacioneve në fuqi si dhe planeve strategjike të miratuara nga KGJK.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me vendosjen e çështjes së parashtruesit të ankesës, meqë me prova të shqyrtuara nuk është vërtetuar se gjyqtarët kanë bërë shkelje të Kodit të Etikës. Ndërkaq, për punën profesionale të gjyqtarit apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**ADGJA.nr.09/2023, me datë 16.11.2023**

**Kryetari i Gjykatës**  
**Valon Totaj**

***Vendimi t'i dorëzohet:***

- *Parashtruesit të ankesës;*
- *Gjyqtarëve M.K, N.B.D dhe H.R;*
- *Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe*
- *Një kopje në shkresa të lëndës.*